



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Prahuar/Pranipeno Me Dana:	16-10-2024		
Nr. Formular	Mesazh Prej	Ditese e doruar	Vlera Vrednost
01-	06	101	1197



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershori 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e X të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **23.10.2024 (e Merkurë), në ora 10:00.**

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e


- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
- Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Shtator 2024**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm publik**
- Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e draft Kodit të Etikës për zyrtarët e Komunës së Vitisë**
- Informatë mbi ndarjen e Subvencioneve në DKRS gjate vitit 2024**
- Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për nëntëmujorin 2024**
- Informatë nga DKA-ja, mbi fillimin e vitit të ri shkollor**

Viti, më 16.10.2024

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E NËNTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.09.2024 (e mërkurë)** në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, znj.Zejnepe Osmani, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtoret e drejtive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përvendetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtoret që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e nëntë të rregullt të KPF-së për këtë vit, edhe pse KPF nuk ka pas pushim në muajin e kalum nuk kemi pas pushim, kemi pas takime me kryesuesit e kuvendit dhe diku 80% e KPF-ve kishin vepru njëjtë, kishin mbajt takim. Tash ju kthehem punimeve të rregullta pas pushimit. Materialin e keni marrë me kohë, nuk e di a ka mbetë ndonjë konfirmim i ligjshmërive që nuk na është kthy deri tani. Para se të hy në rend të ditës hapi diskutimin nëse ka ndonjë pyetje.

z.Jakup Demiri: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Deshta me pyet, kemi diskutu këtu në komitetin e fundit për një rast, një personit ju është djegë shtëpia po nuk e di më nuk kam informat a ka gjetë ndonjë mënyrë komuna me i ndihmu se e kam taku një here ata, por vetëm atëhere kur i ka ndodhë ajo më nuk e kam taku. Dashta të dijë ndonjë informatë çka ka ndodhë më për këtë.

z.Ilir Zuka: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Unë pikë së pari ju uroj fillimin e viti të ri shkollor nxënësve. Po besoj që edhe në Pozheran shumë shpejtë do të zgjidhet, se punët janë tu vazhdu me intenzitet të mirë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Përvendetje për të gjithë të pranishmit! Një kërkësë të tillë e di që e ka bë Jakupi edhe te Zyra e Kryetarit. Nëse është fjala për një rast në Trestenik, është keq, se mundësitet tonë të ndimesës janë minimale, mundësia ligjore lejon maksimumin 490 euro të cilët atij nuk i bëjnë zgjidhje të problemit, se atë ditë kur e ka pru kërkësen kam qenë unë, kam bisedu gjatë me të, ende nuk ish gjetë shkaktari i shkaktimit të zjarrit. Atë ditë kur ka qenë te unë që ja kam preferu, ne ta merrë inspektorin e zjarrit ne ta konstaton që është rryma. Tani përmes gjykatës gjë që është obligative, KEDS-i me bë diçka kompenzi, më përndyshe e kemi këtë gjendje. Donatorët që ndoshta na kishin zgjidh këtë problem nuk kemi momentalisht dhe gjendja është kjo që është, procedur tjetër nuk ka, në këto raste ne nuk kemi formu një fond rezervë të kodifikum. Ndoshta kemi mujt diçka me bë, dhe megjithatë nuk ke, çështja është kjo.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit për kontributin! Materialin e keni marrë me kohë, vazhdojmë me rend të ditës.

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.

- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2025-2027.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues.**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për rendin e ditës. Tani na kanë ardh edhe dy pika, është raporti i auditorit të jashtëm dhe plani i punës dhe na ka ardh një pikë për transferin dhe rialokimin e mjeteve buxhetore në mes programeve, nënprogrameve buxhetore për kategorinë ekonomike të investimeve kapitale. Kategoria ekonomike e investimeve kapitale për ridestimin të mjeteve në mes projekteve, shuma 10 mijë euro, programi buxhet dhe financa 175, nënprogrami ribuxhetimit 17533, kodet, d.m.th 10 mijë euro nga projekti i urave: Jezava, Gelbush, Podgorc, Lubishtë, Budrikë dhe Skifteraj, kodi 55027 në shumën 10 mijë euro në projektin participimi i projekteve me donator, kodi i projektit 90552 në shumën prej 10 mijë euro, d.m.th 10 mijë euro nga urat është bart në projektin participim dhe donator. Dhe kodi burimor, kategoria ekonomike investime kapitale të ridestinohem mjetet në mes projekteve shuma 53 mijë e 73 euro e 76 cent, programi buxhetor, financa 175 programi buxhetimi 70533 nga projekti ndërtimit i urave në projektin 55027 në shumë prej 53 mijë e 73 euro e 76 cent, particimi i projektit me donator kodi i projektit 90552, në shumën prej 530 e 73 euro e 76 cent. A jeni që këto pika të hynë në rend të ditës. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnje votë kundër, asnje abstenim hynë në rend të ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka për diskutim, a jeni që të miratohet procesverbal? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnje votë kundër, asnje abstenim miratohet procesverbal.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2025-2027**

znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2025 është 17 milion e 945 mijë e 622 euro. Krahasuar me vitin 2024 është në rritje prej 1 milion e 287 mijë e 431 euro, apo 7.72%. Sipas kategorive ekonomike kemi ndryshim paga dhe meditje 9 milion e 592 e 934 euro, ku difermeca është 294 mijë e 190 euro; mallra dhe sherbime për vitin 2025 janë 3 milion e 172 mijë e 918 euro; shpenzimet komunale për 2025 janë 30 mijë, diferenca është 5 mijë që është me rritje, subvencionet për 2024 janë 570 mijë, për 2025 janë 720 mijë euro, ku është bërë rritja për 150 mijë euro, shpenzimet kapitale për 2025 janë 3 milion e 365 mijë e 579 euro. Sipas grandeve, kemi rritje te grandi i përgjithshëm për 571 mijë e 408 euro; grandi i arsimit është 6 milion e 887 mijë e 645 euro, grandi i shëndetësisë është 1 milion e 927 mijë e 785 euro; dhe të hyrat vetanake janë 1 milion e 270 mijë e 121 euro, ku rritja i bie për 240 mijë e 625 euro. Numrin e stafit vitin e kalum e kemi pas 1171, ndërsa për këtë vit është 1104 euro. Kisha dashtë me shtu jashtë buxhetit dhe diçka tjetër me ndryshu planin. Tash që e ceka më herët, në kategori shërbime dhe mallra, shkaku është për hartat zonale. Ne i kemi diskutu me ZKF për me i hekë për të gjitha nga pak, për mallra, shërbime publike. Tek inspeksioni dhe Drejtoria e Kulutrës, që me ja bë një shumë 100 mijë euro, me shtu te urbanizmi nëse jeni dakord duhet me patjetër me i shtu 100 mijë euro, por po du këtu me diskutu me juve, për kuvend kjo vjenë me ndryshim.

z.Jakup Demiri: A është kry faza e prokurimit të hartave zonale.

Znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Unë kam shku kam pyet në Prishtinë dhe kam mbajtë takim. Ky nuk është projekt. Po të ishte projekt e kishim shti tek investimet kapitale, po mua më kanë thanë që nuk ke të drejtë me shti në investime kapitale, shko me procedura të prokurimit shërbime dhe mallra, mandje është dashtë me ardhë me

tregu që kemi me i zvoglu të tjerat për me i plotësu këtë çka e kemi. Ne kemi bë një zotim, se pa e bë zotimin nuk mundemi me qu te Zyra e Prokurimit. Është zotimi tek financat, 5 mijë euro janë të zotume dhe 5 i kemi siguru përmuajin që vjen për me bë marrëvejshen, madej prej janarit e më vonë është pagesa tjetër, tash që e shtimi me projekt tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo është përgjedh më heret në qershorr-korrik, ka qenë veç një operator që ka konkuru, mirëpo ka pas komplikime për nënshrkimin e kontratës për shkak që nuk kanë qenë mjetet e koordinume në kodin që është parapa dhe tash nëse është bërë zgjidhja, është caktu kodi që ju ka përshtat, atëherë mundet me u nënshkru kontrata. Ne e dimë që hartat zonale nuk ka pas mjete të planifikume, për këtë vit ka qenë me marrëveshje marrvjeshen e kemi anulu gjatë vitit për shkak kërkësës që ka qenë me u anulu, dhe d.m.th ka dalë me procedurë të rregullt. Procedura e rregullt kur ka dalë nuk ka qenë i parpamë kodi për këtë projekt dhe për atë janë kompliku. Tash për vitin e ardhshëm do të përcakohen paret, mirëpo projekti i tillë nuk është projekt që i takon investimeve kapitale po është projekt që kalon prej shërbimeve dhe mallrave dhe për këtë arsy kodi duhet të jetë i përcaktum në sherbime dhe mallra që po e kërkon drejtoresha për vitin e ardhshëm.

z.Majlinda Shabani: Unë dashta me diskutu për çështjen e materialit, se paraprakisht kur po thirremi përmbledhjen e komitetit, por edhe në seancë kemi pa praktike të vazhdushme që materiali të na vie aty për aty. Rastin e njëjtë e kemi edhe sot me listën e emërtimeve të projekteve kapitale. Temë e diskutimit e kemi planin e buxhetit, ku e dinë që tërë fokusi jonë është tek investimet kapitale dhe sot vina në komitet, në mbledhje na vjen p.sh.: lista e projekteve të investimeve kapitale dhe nuk e dimë se qysh kemi me arritë me diskutu në listimin e emërtimeve të projekteve kapitale, edhe pse kemi me pas kohë tash gjatë diskutimit, po për mua kjo praktikë që është tërë kohën është tu apliku për mua është e pa pranushme, andaj unë kërkoj prej gjithsecilit me qenë më i diciplinun në kët aspekt dhe çështjen e planifikimit dhe çështjen e bartsve të mjeteve, sepse shpeshherë po janë të pakuptimta përmu përderisa nuk e kam materialin në dorë. Natyrisht që të vyen kohë me analizu me marrë informacionin dhe më heret me i shfaltu disa faqe me pa, dhe mandej me zgjedh një qëndrim, se jemi tu diskutu jo për çëshjte minore, janë taksat, d.m.th është paraja publike që është ka shpenzohet, dhe natyrisht që na duhet me qenë shumë në nivel sa i përket diskutimit, dhe përmu kjo është vërejtja më e madhe që e kam, pa hy në diskutimet tjera.

z.Jakup Demiri: Për këtë pjesën teorike nuk kemi çka e perserismi. P.sh.: buxheti është instrumenti më i rëndësishëm, p.sh.: unë dje kam pas mbledhje në VV dhe prioritetet tonë sunë i qesim si lëvizje VV, se unë nuk e kam qëta. Tash vijmë në mbledhje ne këtu formalisht, pse ne kemi me diskutu përmuatheit tash. Ka të gjetura edhe ne që mundemi me folë, po esenca është qëkjo te investimet kapitale. P.sh.; sa prej këtyre projekteve, se unë nuk e di që janë të përseritura, tash çka janë të bartura prej vitit tjeter. Tash është kanë mirë këtu me diskutu, se javën tjetër e kemi votimin e buxhetit me dalë dhe në teren me kqyr për ato çka kanë mbetë sa është punu. Po marrë shembull, 75 mijë euro ndërtimi i kanalizmit Viti, Kabash, Binçë, Germovë, Drobesh, Beguncë, Skifteraj dhe Budrikë, prej këtyre në 75 mijë euro diku nuk i bjen as ka 11 mijë euro me investu. Asfaltimi i rrugëve Viti, Lubisht, Beguncë, Kabash, Buzovik, Drobesh, Ramnishtë, Smirë, Podgorë, shuma është 140 mijë. Krejt fokusi te unë është tek investimet kapitale te lista. Përpara nuk na ka ardh as kjo këtu, e kishim problemin ne, se nuk e dishim as çka kishim me votu, veç u ndajke si shumë. Unë kurrë informacione si asamblist nuk kam pas. Për sheshin pyesin qytetarët, ne nuk e dimë as dinamikën e punëve. Ne kemi pas shpresë që do të kryhet në gjysmën e pushimit të mergatës, sot po e kryejmë mujin shtator dhe nuk është askund. Kemi rrugë që janë bërë 2 kahje dhe nuk kanë vendim të kuvendit komunal. Unë kam projekt në Smirë, i ka kalu 3 vite që ka fillu projektin i trotuarit, që janë gjysma e nxënësve të fshatit tim. Ka gropë që janë 70 cm. Unë pata me diskutu ende, por po e lë dhe përkuvend, por neve na vjenë një listë në momentin e fundit, që kjo donë një analizë përm diskutim. Neve na duhen dhe konsultime me profesionista të fushave të caktuara. Kishte qenë mirë ndonjëhere dhe me i thirrë jashtë KPF-së grupet parlamentare kush donë me ardhë me diskutu, se është paraja e komunës përm me i diskutu problematikat cilat janë. Unë i kam 4 lagje në fshatin Smirë, këtë vit ka qenë dhe vera më e nxehë që ka kundermu kanalizmi në fshatin tonë.

z.Ilir Zuka: I pashë shumë punë të mira që i kanë shti këtu në lista, por unë disa kërkesa do t'i bëjë, se më takon si anëtar i KPF-së dhe si asamblist. Më pëlqej kjo ideja që një palestër shkollore ju ka nda Smirës. Këtë

shtegun e di që eshtë me kontratë sociale dhe kjo ura që e keni futë, por unë mendoj që duhet të jetë një urë me u cekë në Pozheran. E di që njëhere ka qenë, por u hjek dhe eshtë një urë që i lidhë 2 pjesë, dhe shtegun për bicikleta ka ardhë koha me bë, eshtë prej Letnicës deri në Terpezë, një shteg që del i jashtëzakonshëm. Kemi hapësira sa të duash. Më erdh mirë që ish kodi buxhetor. Për tribunat e stadiumit të Pozheranit kemi bërë kërkesë dhe në ministri, ministria nuk e ka parë të arsyeshme me investu në Pozheran, se i ka qu në Kamenicë dhe në Shtime ka 2 milion euro. Kërkoj drejtoreshë me pas mundësi, mbrapa stadiumit "Ibrahim Kurteshi" eshtë një hapësirë e madhe publike. E di që kanë nevojë për një parking.

znj.Majlinda Shabani: Për mua eshtë qështja e lisitmin të emertimit të projekteve dhe prej kësaj që po shofë sot jam shum i sigurt deri te numri rendor 15 jan komplet copy paste të bartura prej emertimit të projekteve qysh prej fillimit të mandatit kuvendit komunal dhe sot na ka ardh pikerisht kjo mandej e ki te numri rendor deri te numri 35 mandje këto projektet e reja që po i shohim që jan edhe si shej që kan hy projekte të reja që fillojn prej 35 ku nuk ka numer rendor te 37 unë realisht ajo qka po pres deri në fund kur të bëhet plani komplet i buxhetit dhe tu marrë parasysh degjimet buxhetore që janë bërë unë realisht kam qenë shumë idhtar dhe gjatë diskutimeve të myja që shpesh herë jam akuzu nga kryatari që nuk po e votoj buxhetin dhe arsyetimet e mia vazhdojn me qenë të qendrushme unë pres që në prioritet të listimit të emertimit të projekteve kapitale me qenë qështja e ujit të pishem eshtë njëra prej problemeve themelore që e kan qytetaeret e komunes së vitis unë nuk e di kryetarit a nuk po i doqet që mjatushem ka bë asafaltim të rrugeve nuk e di se ku dhe cilat rrugë kan mbet pa u asfaltu dmth ki asfaltim të rrugeve ki lokalitetë të komunes së Vitis të perfshime e tash qe 4 vite kemi parë veq asfaltim që eshtë ka shtron kemi pasë edhe shumë degjime buxhetore që jan mbajtë më heret ku kam qenë pjesë dhe kmei pasë shumë diskutime konstruktive ka qenë një gjuhë bashkpunuse prej nenkryetarit jan kriju pershtypje të mira që mundemi me pasë ndonjë bashkpunim mundemi me qenë aj zeri i qytetareve që degjohet prej seciles parti mirpo në fund kur të mrrin lista finale e emertimeve të projekteve prap se prap fillon praktika e njejt unë e di që kemi pasë një qështje që kemi diskutu qent endacak në komunen e Vitis janë një problem shumë i madhë për strehimore kemi pasë problem mirpo megjithatë kemi diskutu dhe një qender trajtuse të përkoshme sa i perket qenve endacak dmth kan qenë disa prej pikave që i kemi përmend kemi pas dhe raportet se sa jan perfshi degjimet buxhetore në pergjethsi dhe unë kam prit një lloj reflektimi se po më duket që realisht në këtë aspekt komuna eshtë ka funksionon ad hock sa i perket analizmit që mundet me bë rrreth nevojave që i kan qytetaeret e komunes së Vitis, për mua kjo listë e emertimeve të projekteve kapitale dhe shumë punë që ceken këtu që jan kry dhe që kan me u kry nëse dalim me folë me gjendjen faktike që eshtë delë krejt diqka tjeter, unë po pres të pakten deri në fund kur të behet me qenë pak më të specifikum dhe sa i perket transparencës se kemi me pasë diskutime të gjata dhe përmu nëse vjen në këtë fomrë ka me qenë kritikuse.

z.Illir Zuka: Kam bërë dhe një kërkesë para 2 seancave për këtë rrugën që eshtë afër shtëpisë së kulturës, që atë pjesë të rrugës me bë 2 kahje. Të hiqen shkallët që janë aty, sepse ne nuk po mundemi me hy nëpër parkingje që të lidhemi në rrugë me ardh te qyteti.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Nga diskutimet e juaja eshtë një emrues i përbashkët për çështjen e vonesës së listës së investimeve kapitale që pajtohem me të, por megjithatë unë po besoj që serish kemi një kohë prej 7 ditesh, të cilët keni kohë, hapësirë me i shiku dhe me i dhanë vërejtjet e juaja për kuvend. Ajo çka më bjen në sy, ndoshta unë nuk kam të drejtë me pyet, por po e konsiderojmë se krejt paraja publike eshtë edhe e kuvendit dhe e ekzekutivit. Unë arrita me i ndëgju rend pa i nderhy askujt, pa e ofendu askënd, pa e linqu askënd, por megjithatë jam nënkyetari i komunës dhe në këtë rol kam drejtë me bë pyetje, pavarësisht se janë mjetet të kuvendit, por po flasim për paran publike dhe në rastë se një këshilltare e kuvendit komunal e mbiçmon veten se unë i di të tjeret ne ti mbajn këtu, unë konsideroj se këtu ja ke siguru përmjet pune dhe unë veç pyeta a ta kanë dhanë laptopin apo ka nevojë me ta siguru, se eshtë mjet i punës, i këshilltares/it. Unë përkundër moshës 62 vjeçare i lë 2 orë ne të flasin, curr nuk i ndërhy as nuk ofendoj. Çështaj e ngritjes së tonit nuk më frikon, nuk kemi nevojë me mat trimni këtu, për mua ka profesionalizëm. Konisderoj se kategoria më e rrezikshme e shoqërisë eshtë injoranti dhe nuk e thashë rastësisht se më ka ra në sy shumë here, në rastë se dikush e ban laptopin, dikush nuk e ban, unë kam drejtë me pyet, se i injoron këta 7 tjerë. Po vazhdojmë tek pyetjet tjera që kenë deri te nr. 15, nr. 30. Unë po konsideroj që propozuesi i buxhetit në kuvend do t'i sqaron të gjitha edhe projekte të cilat jan 3-

vjeçare, që janë të përsritshme dhe ato që janë 2-vjeçare, por edhe ato të cilat janë të reja. Kontrata sociale, përkundër një përvoste time bukur të gjatë që e kam, përshtypjet e mia të cilat më kanë lanë me Smirë, që kemi aplikuar për herë të parë unë si nënkyetar komune. Në përfundim të dëgjimeve buxhetore i kam propozuar kryetarit të komunës që, kryetar ndoshta ky 1% i investimeve kapitale, në rast se ka mundësi për 2024 për vitet tjera me rrithje jo 1 po 4-5%. Për çka po të drejtohem Jakup ty me emër, me zgju interesimin e qytetarëve sikur atë ditë në Smirë me u bë 50 dhe më ka thanë, po ta shohim tash propozimin për vitin 2026 kur ta bajmë propozim buxhetin, me zgju interesimin e qytetarëve që me thanë qytetarët që ekzekutiva po e vendos një projekt që të cilin ne e dojmë. Kemi bë përpjekje maksimale me hy, ato të cilet janë me prioritet dhe ata të cilët me të vërtet kanë popullatë, unë nuk e shëmangj atë që kam partnerin e kualicionit, eshtë propozimi i kryesuesit për Smirë, që konsideroj eshtë e qëllume. Për çështjen e ujit, po e themë me sinqeritetin më të madh. Po mendon që nuk eshtë edhe tek ne brengosese çështja e ujit, a nuk janë duart e zgjidhura të operimit ju qysh po mendoni. Më se 2 vite pa ndërpren mirrem me çështjen e ujit, por për shkak se kemi fitu një projekt i cili projekt eshtë i huaj, që kap shumë mbi 3 milion, në Letnicë. Unë kam qenë në takimin e fundit në Prishtinë, e kam bërë ekzekutimin e 10 mijë eurove. Ja ku eshtë drejtoresha, kam thanë, drejtoreshë, a më bënë ekzekutimin me 2 tetor 6 mijë që unë duhet me bë bartjen e pronës, më bë pronë të komunës, me dërgu në "Hidromoravë", ata me ja dërgu Bashkimit European, Bankës Botërore dhe që me dalë tenderi në janar, veç me u shpall fituesi. Tash mi kanë kthy paret, andaj ti nuk mundesh me shti kod të rritjes së kapacitetit të ujit, se e kemi projektin e fitum. Veç duhet me i kry detyrat, po dalin pengesat, sun e kemi gjetë njerin. Tash ma kanë kthy prej ministrisë, ke forma tjera, unë nuk kam forma tjera. Ju si kuvend e keni shpallë zonë me interes të përgjithshëm, mi keni zgjidh duart, i kam siguruar mjetet, e ka vlerësu komisioni, nuk di çka bëjë tjetër, dhe jam në këtë fazë dhe rritja e kapacitetit të ujit, modernizimi atje, krijimi në radhë të parë i pronës dhe krejt ato besoj që shumë lokalitete të cilat kanë rrjet ka me i furnizu. Ajo eshtë një e ardhme që nuk po guxoj me thanë e sigurt, se nuk eshtë në dorën time këtu, po varet edhe prej të tjereve, por punë në këtë drejtim eshtë tu bë bukur shumë. Sa kemi me ja arritë, aq sa mujmë dhe na lejojn mundësitë.

z.Jakup Demiri: Nënkyetar, krejt në rregull jemi tu folë për buxhetin, dhe kjo me projektet që bartën, që nuk kryhen sivjet, kisha dashtë me ditë cilat janë, cilat nuk janë. Kam edhe një shqetësim tjetër. P.sh.: në qershor disa komuna KAB-in kur e kan bërë, qek jo eshtë punë, se ke deri në shtator me diskutën, me kqyrë, po jo hajde votojë që listen nuk mu përgjigje këtu krejt në rregull. Për te puna e ujit, tash ne e dimë që janë nda diku afér 6 milion euro për disa komuna. Komuna e Vitisë eshtë kogjo përfituese, po kemi problem me parcela këtu. Dani e di që ka pas thanë më heret, veç qelmani deren ja u gjaj njerin për 24 orë. Për që nuk eshtë vonu e që nuk eshtë sabotu nuk eshtë më bind, se e di që eshtë sabotu. Të pakten kurr nuk ketë në gjendje me kërkua falje, se jemi tu fol për ujë të pijës. Unë si asamblist kam hi në 2017, e kam pas marrë si obligim vetit që mos mujsha me ditë tjera ka në Smirë, e di sa bunare hapen, jam shku te "Hidromorava", kemi diskutën dhe thanë që duhet diku 70 mijë euro investim për me rrithje kapacitetin e ujit, se ishte kry puna e rrjetit, ujësjellësit në fshatin tem, po ujë nuk kishim. Gjatë mandatit 4-vjeçar, në Smirë e kam diferençën 212 - 214 bunare janë hapë ka 1500 euro, tash ne po himë në vitin e 4 që tash 3 vjet në fushat 24 fshatra i keni pasë për ujësjellës. Fatkeqësisht ata që udhëheqin komunën nuk kam respekt, po më vjen keq edhe me thanë, po unë kam respekt për ty dhe disa tjerë, kam respet shumë më shumë se disa tjerë që i kam në Vetëvendosje. Problemi i komunës sonë me ujë të pijes nuk eshtë trajtu serioz. Kur në ish Jugosllavi ka dokument që, Komuna e Vitisë eshtë më e atakume për ujë të pijes, se ka qenë rekord për sëmundje të veshkave dhe ne ende pritem me ka 20 vjet mas luftes, pritem çka po ndodhë me ujë të pijes. Sot eshtë nda ajo Vitia, eshtë në projeksion të mirë. Telashet me shpronësimë, me gjëra tjera u dashtë mu kry shumë më heret që Komuna e Vitisë prap nuk e di, por sa kam informata, sa prona i keni qu në shpronësim në Ministrinë e Financave, në Sektorin e Urbanizmit Vitia, veç 1. Komuna e Prizrenit i ka qu diku 56 shifra. Më e vogël që ka qu eshtë 25. Komuna jonë e ka veç atë dhe kjo eshtë një vërejtje.

(ingjizimi ka ngecje nuk kuptohet)

z.Ilir Zuka: Vitin e kalum eshtë kanë si temë që veç me shti si kod për tribuna me lanë si kod buxhetor për shkak që ne kemi pas takim paraprakisht me ministrin. Krejt çka ka thanë ai veç lene kodin që mos ta kemi

problem pagesen.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Unë vetë e kam dorëzu një, unë vet kam nejt me ministrin e ambientit, unë e kam qu, unë e kam nënshkru, nuk është aprovu komplet 3 milion e gjysë, është aprovu 1.5 milion.

z.Jakup Demiri: Unë nuk e di nënkyetar, unë kam dokument zyrtar prej GAP-it.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Projektin që e kemi dorëzu vitin e kalum e kemi 3 milion e diçka mijë.

z.Jakup Demiri: Ti qata duhet me ma pru në KAB me diskutu, e qëto krejt kanë shku nëpër KAB-e të tjera. Për qata ju që kontrabandoni projektbuxhetin nënkyetar.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Mos e përdor këtë fjalor! Unë nuk muj me pranu dezinformatë, se unë të ofroj fakt.

z.Jakup Demiri: Birem dokument që është dezinformatë, bire një vendim të tyre që kanë gabu me këtë, atëherë jemi në rregull. I kam investigu 15 komuna, në mesin e tyre edhe Vitia. E vetmja Komuna e Vitisë nuk e ka asnë projekt.

z.Majlinda Shabani: Për çëshjten e ujit të pajes unë lypa arisetim prej nënkyetarit, edhe pse përmua nuk ka mundësi për arsyetim, se përderisa për 10 vite qeverisje nuk është bërë një analizë e duhun, një qasje e duhur rrëth këtij problemi, përderisa për 10 vite nuk ke arritë me zgjidhë këtë problem, përmua nuk ka shpresë më, se nëse ti ke pas probleme ose pengesë që të kanë dalë në rrugë, nuk munden me qenë 10 vite pengesa që me qenë të pazgjidhshme. Është transformu Komuna e Vitisë si përmja si përmja aspekt të investimeve që janë bërë në sektor tjerë. Çështja e asfaltimit, ndërtimit, e kuptoj edhe këtë pjesë, ama çështja e ujit të pijshëm është diçka që realisht përmua nuk donë arsyetim dhe përmja këtë e përmenda, se tek listimi i emërtimeve që i kemi aty te asfaltimi, mandej te puna e tryzes që e diskutoj Jakupi, përmua ke shumë e kuptushme, ndoshta muj me ndryshu formën pak të propozimit që dha Jakupi, sepse po konsideroj që përderisa bëhet një emërtim i projektit, p.sh.: e marrim ku është bërë asfaltim i rrugeve Viti, Beguncë, Lubishtë, Kabash, Buzovik, Drobesh, Ramnisht, Smirë. Para se mu bë ky emërtim, është bërë një lloj analize. Ti ke mri në një farë lloj përfundimi, pse është dashtë me u bë ky emërtim dhe të paktën çka mundemi me kërkua. Ne si asamblist është që, këto emërtime që janë bërë me u arsyetu, sepse as arsyetimin nuk po e kemi. Unë nuk mundem me pranu me ardhë në buxhet me votu qekjo formë këtu ku nuk e arsyeton këtë investim që ki me bë dhe është e njëjtë prej viteve të kalume, arsyetoj njerëz që i ke kompetent, që janë marrë me këtë emërtim të projekteve, tu e përfshi edhe drejtoreshën e financave, komplet stafin e vetë, përderisa bëhet një emërtim i projekteve i kanë disa pika reference ku ato referohen dhe bëhet një emërtim. Të paktën qëta me argumentu që edhe ne me pas më të qartë, por edhe qytetarët, se përnjëmend paska nevojë me u shtrua një asfalt në filan venin dhe tanë ta dimë çka jemi tu votu. Përmua kjo është e rendësishme. Këto tema tjetra çka i kemi goditje politike që i patëm, nëse flas Ilir me emër përmty, ti e dinë që unë kam shumë respekt përmty. Përmua këto tema janë të parëndësishme, përderisa sot folim përmja buxhetin e komunës edhe puna e kësaj e asaj dhe ballafaqimet që i kemi në kuvend. Të jemi transparent karshi kësaj, akuzat dhe këto goditjet tona që i kemi si asamblist përmua nuk qojnë peshë fare.

z.Ilir Zuka: Një orë nëse folë në të mirë të qytetarëve unë të dëgjoj. Unë një kërkësë e pata shumë të nevojshme përmja qytetarët e Vitisë. D.m.th që e ceka përmja rrugën në mënyrë injorante keshet, por mua nuk më pengon.

z.Jakup Demiri: Pa ardh këtu e diskutum qat problem Komunën e Prishtinës. Unë jam munu me përbajt veten, se kur e kam ni këtë që thave është kanë sikur me të ra. Nuk ka të bëjë me ty. I njëjti problem në kafe këtë muhabet e kishim kur e the këtë.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Majlinda, po të drejtohem tani me emër. Gjithmonë sinqeritetin më të madhë e kam përdor, por nganjëherë ma ke bishtnu. Unë thash, emërusi i përbashkët i joni i egzekutives në këtë rast unë që e përfaqsoj dhe kritikat e juaja janë se, lista e projekteve na ka ardhë me vonesë, por nuk po mundet me më bind mu se ti pa laptop je e përgaditur përmja komitet. Unë po i pranoj lëshimet e mia, ti nuk po je në gjendje 23 vjeçare me i pranu dhe kjo ishte pikërisht atë që ta thash. Më the po e devijon! Jo nuk po e devijon, po rend të ditës tash e tutje faleminderit prej laptopave. Na keni kursy me letra. Ne nuk ju dërgojmë letra juve. Ti vjen si zojë me durë në gjepja, unë nuk e kisha leju veten, dhe pyetja ime ishte, a ta kanë dhanë laptopin a nuk ta kanë dhanë. Nuk ta kanë dhanë me intervenu se nuk është i saj.

z.Jakup Demiri: Kjo është një temë tjetër, por Majlinda njëmend ka ardh prej qendrës klinike.

z. Hasan Aliu, nënkyretar i komunës: E ajo është dicka tjetër.

znj. Majlinda Shabani: Nëse e kish pas shqetësim, a kam apo nuk kam laptop, ti kishe mujtë me pyet. Kjo i bie mandej me kërku prej gjithsecilit anëtarë të kuvendit që e kemi a e kanë apo nuk e kanë laptopin dhe diskutimi im ke krejt diçka tjetër.

z.Hasan Aliu, nënkyrytar i komunës: Majlindë, ti nuk mundesh me më bind mu nëse nuk e ke laptopin që je e përgaditë për mbledhje, se material nuk ka.

znj. Majlinda Shabani: Nënkryetar ka me ardhë kohë dhe në kohë fushate me pas debate dhe ne nuk mundemi në këtë rast me pas një debat dhe për problemet e Komunës së Vitisë kemi me shku ne në emision me laptop. Unë duhet me pas laptopin përpëra me diskutu për problemet. Nuk kam nevojë për këto çështje, që 4 vite jam asamblist, përmendësh i djë këto probleme.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Laptopat kuvendi ja u ka ble për mos me qu materialin fizikisht. Është çështje e këshilltarëve sa lexojnë. Ata çka kanë pas defekte ja u kemi riparu. Çështje tjetër është kush merr laptop e kush nuk merr, çështja është që duhet të lidhemi tek pikat. Ligji thotë që materiali duhet me ju dorëzu deri me 1 shtator kuvendit, pa listen e investimeve kapitale nuk ka bë, po të themë je drejtoreshë këtë vit nuk të kam dërgu e-mail viteve tjera ju kam dergu e-mail. Ju lutem, afati ligjor është me 1 shtator, që duhet me u dorëzu në kuvend. Ligji e thotë komplet duhet me u dorëzu, mu njoftu me 3 shtator për këtë listën e investimeve kapitale në kuadër të saj e kam futë qëta, sallën e edukatës fizike në shkollën e Smirës, 35 mijë euro, këto janë veç me i shti këtu, për mu është hajgare 17 mijë euro rivitalizimi i ujësjellsit Remnik, Beguncë, Budrikë, Skifteraj, Verban, Smirë, Tërpezë, po nëse u kanë në pyetje për këtë shumë neve u dashtë me na mytë për këtë që nuk kanë ujë ose këto tjera me 50-60 mijë euro asnjë katun nuk rregullohet me këtë hiq 30% e buxhetit ja kemi dhanë vërejtje edhe aty kur e kemi formu janë asflatime të rrugëve rurale është e papranushme dhe kjo në ujë 50-60 mijë euro ajo është e papranushme, po çka kemi arritë si kuvend kemi arritë kur e kemi marrë Majlindë, se këtë diskutimin e fundit ta pëlqeva atë çka e lidhi konkretisht. Kur e kemi marrë 2014 deri 13 u kanë numri. Naimi ka qenë kryesues, çdo vit e kemi ritë numrin kapital, kemi arritë 45-46 projekte, d.m.th është bërë një kontribut i presionit i vazhdhuashëm prej krejt anëtarëve të kuvendit në forma të ndryshme, që unë mendoj që ka pas hapësirë me pas edhe tjera. Në përgjithësi pajtohem me diskutmin që lidhen, po krejt këto investimet e mira është që realizmi me u bë mirë. A u diskutu në kuvend. Parimisht kuvendi po ka pak qasje, deri sa po e miratojmë dhe për me miratu po duhet kuvendi, d.m.th nuk e kemi taman atë informatën. Duhet me na pru në kuvend me na sqaru cilat janë që vazhdojnë, se përime jan disa projekte, ki 10 -12 që vazhdojnë, janë të kryme tenderimi, janë 2-vjeçare. Tash kur e patem raportin e prokurimit, aty e pamë që shumë projekte çka janë këtu nuk janë tenderu, se kanë qenë 2-vjeçare dhe u bajtë në pjesën tjeter. Drejtoreshë, këtu më duket që është një gabim, ndoshta na sqaron tek stafi. Me qarkoren buxhetore i kemi pas 1144, tash te stafi është 1181. I ke të shtume 21-22 i ke në shëndetsi. Tash në shëntetësi është tu diskutu, po shpallshin 20 vende të punës, asnjë vend nuk shpallet, ti e dinë tash në arsim janë +12 vende. Ne e dimë që në arsim janë 10 për çerdhe, tash është ngarkesë, te arsimi i ke plus 2 te kyretari siç janë shpërndë këtu është gabim, se unë sa e di, për herë të parë është lidh që janë shti dhe 27 anëtarë të kuvendit. D.m.th janë veç 10 vende që qëtu duhet me u përmirësu në kuvend, se kjo listë për 2025 me këtë numër që të paraqet ty të qetë telashe dhe ty dhe neve, se qëtu e ke në shëndetësi 20 vende. D.m.th kjo është mirë me rregullu për qarkore. Pasi që nuk ka për debat, a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër asnjë abstinenim, kjo pikë shkon në kuvend.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjibja

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: 99% është e njëjtë me vitet tjera. Këtë vit nuk e kemi parapa se shumë komuna nuk e bajnë për çdo vitë na kanë pas obligu një kohë me bë çdo vit. Tash jemi konsultu edhe me ministri. Ne nuk e kemi bë për 2025, po e kemi bë vetëm si rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Deri sa ka nevojë nuk ndryshon. D.m.th mos me ba diçka tjetër nëse nuk ka ndryshim që kërkohet nga ministria.

z.Jakup Demiri: Unë po lidhem pak te parkingu publik. Nuk e di a ka ndonjë strategji komuna me implementuar këtë punën e transportit publik dhe me pas një hartë. Është mirë me pa ka është, se ne i kishim vëc 3 rrugë. Rruga

“28 Nëntori”, “Adem Jashari” dhe një tjetër. Tani është ai nen 13.21, 13.22, që disa operator dhe banues i hjek prej pagesës, ndërsa është e përcatume pagesa për një muaj, nëse jeton aty e ke 8 euro, për operator 25 euro. Kjo bjen ndesh njëra me tjetren. Nuk mundesh nëse ta liron prej pagesës banorin ose operatorin ekonomik dhe të njejtën kohë me i qitë taksë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Operatori është përfitues, banori është jetues. Duhet me pas taksë ndryshe.

z.Jakup Demiri: Po edhe operatori ekonomik mundet me u stimulu. Edhe në këtë formë më parë e kemi pas 10 euro dhe sa ka mundësi me pas parking.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kjo është veshtirë edhe vitin e arshëm me hi, por mbisin si tarifa që mundet me mbetë. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në kuvend.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kemi qitë në diskutim publik, në seancen e fundit ka qenë në diskutim, kemi mbajtë debat me qytetarët, kemi mbajtë në fund një takim me grupin punues. Në përgjithësi plani është me pak ndryshime. Një pjesë të materialit veç e keni, nuk është strikt, sepse e dinë që mund të vijnë edhe pika tjera në kuvendin komunal, etj. Hapi debat për këtë pikë.

z.Jakup Demiri: Këtë planin e punës që keni diskutu, se nganjehere disa vendime na vijnë. Më duket 2 ose 3 vendime i kemi pas lanë në zyre, nuk i diskutojshmi, se dalshin në kundërshtim me planin. Ish kanë mirë me i nda sketorët dhe me u konsultu dhe me planin e punës. Ka qenë një për një rrugë kur kemi votu, por si probkematikë është shfaq. Për kuvend disa gjëra duhet me i ndryshu këto tarifat e mërgimtarëve. Pagujan disa taksa. Ish kanë mirë me i diskutu, ish kanë mirë me organizo një takim me ndonjë përfaqësues të mërgates, po e jap si ide, e ka bë Komuna e Shtimes, kanë diskutu për të gjitha problematikat e tyre, ish kanë mirë edhe ne me bë atë.

z.Hasan Aliu, nënkyetar i komunës: Kryetari i komunës për çdo vit i bënë nga 2 takime, i mirëpret, vijnë aty, i shfaqin propozimet e veta. Tash në rast se e kë pritje të mërgates.

z.Jakup Demiri: Jo, një takim me bë formal, me diskutu, se ne si kuvend komunal kemi me i votu çështjet dhe ne me qenë prezent.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne edhe atë ditë në kuvend e patëm një debat që me qenë kuvendi i hapur për mërgimtarët, mirëpo në atë aspektin ne çka e diskutum, nuk e shtinëm, se kjo është teknike. Ne zakonisht e shtimi punën e kuvendit. Puna e kuvendit janë seancat, ndërsa ajo mundet me u organizo pa u kanë plan.

z.Jakup Demiri: Qaty ka qenë dhe një kërkesë dhe të gjitha komunitat bajnë një kërkesë te Ministria e Infrastrukturës, që këta mos me pagu për vetura që i kanë 12 muaj regjistirim dhe sigurim të kerrit. Ajo është me ligj, po atë ligj me rregullu me presion prej të gjitha kuvendeve të Kosovës.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më për debat e qes në votim. A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim kjo pikë shkon në kuvend.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues

z.Naim Pira, drejtori: Përvendosje për të gjithë të pranishmit! Kemi sjellë një propozim vendim për aprovin e buxhetit për subvencionim të përfituesve mekanzmit bujqësor në kuadër të drejtorisë tonë. Na ka ardhë një shkresë nga ana e Ministrisë së Financave lidhje me procedurat e menaxhimit dhe pranimit, alokimit të mjeteve, mbështetje të menjëherëshme dhe participimin e qytetarëve. D.m.th nuk është vendim, nuk është udhëzim administrativ, po na ka ardhë si shkresë vitin a kaluar dhe parashihet që perqindjen të cilën e participojnë, këtë rast përfituesit e subvencioneve të kalon përmes kuvendit. I kanë parapa edhe format dhe mënyrat e dokumentacionit tjetër, që ato në realitet janë të realizume. Tash vetëm vendimi vjen nga ana e kuvendit komunal,

mjetet janë janë pagu të gjitha këto, tash Drejtoria e Financave kërkon që të merret ky vendim në mënyrë që mjetet ti qes në atë presekin të cilët duhet me qenë, në mënyrë që të ju paguhet operatorëve ekonomik që janë përfitues. Kjo është kërkesa dhe besoj që do ta gjejë mirëkuptimin e juaj. D.m.th në korrik të vitit 2023 ka ardh kjo shkresë, është si risi, se më heret nuk ka qenë.

z.Ilir Zuka: Drejtor, të uroj punë të mbarë pas një sfide që e ke kalu, ti uroj më të mirat e jetës për këtë periudhë, d.m.th pas gjithë asaj sfide na u ke bashkëngjitur në tavolinë.

z.Naim Pira, drejtori: Faleminderit shumë! U jam mirënjoës të gjithë atyre që përmes shkresave, përmes komunikimit që më kanë inkuraju, mirë jam me shëndet, shpresoj ta marrë veten dalë nga dalë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Pasi që nuk ka më për debat e qes në votim: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim kjo pikë shkon në kuvend.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim vendimi për transferimin e mjeteve për rialokim

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Materiali ju vjen në kuvend. E qes në votim: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në kuvend.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Informatë për raportin e auditorit të jashtëm dhe plani i veprimit nga komuna

